



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 5 korrik 2013  
Nr. ref.: AGJ464/13

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin Nr. KI80/12**

Parashtrues

**Sali Pepshi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të  
Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 164/2011, të 5 korrikut 2011**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Sali Pepshi, me vendbanim në Junik.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston mosekzekutimin e Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 164/2011, të 5 korrikut 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 15 korrik 2011; Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Deçan, E. nr. 648/2010, të 18 prillit 2011, dhe të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPM), nr. 02 (67) 2010, të 11 majit 2010, nga ana e Komunës së Junikut.

## **Objekti i çështjes**

3. Kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me ankesën e tij për moszbatimin e vendimit administrativ të KPMK-së dhe të vendimeve gjyqësore në procedurën përmbartimore nga ana e Komunës së Junikut, për kthimin e parashtruesit në vendin e punës, në përputhje me këto vendime që janë në favor të tij.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit dhe rregulli 56 (1) i Rregullores.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 3 shtator 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 tetor 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI80/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, me Vendimin Nr. KSH. 80/12, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).
7. Më 1 nëntor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Komunën e Junikut, KPM-në dhe Gjykatën e Qarkut në Pejë, për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
8. Më 6 nëntor 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe nga Komuna e Junikut që, në afat prej 15 ditësh, të dorëzojnë në Sekretariatën e Gjykatës Vendimin për largimin e parashtruesit të kërkesës nga puna, të lëshuar nga Komuna e Junikut.
9. Më 13 nëntor 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata Komunale në Deçan që, në afat prej 15 ditësh, të dërgojë në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës E. Nr. 648/2010.
10. Më 19 nëntor 2012, Komuna e Junikut e dorëzoi në Gjykatë Vendimin për largimin e parashtruesit të kërkesës nga puna.
11. Më 22 nëntor 2012, Komuna e Junikut, duke iu referuar shkresës së Gjykatës të 1 nëntorit 2012, dorëzoi në Sekretariatën e Gjykatës përgjigjen që ka të bëjë me

justifikimin e Komunës së Junikut përkitazi me moszbatimin e pikës 2 të Vendimit të KPM-së, Nr. 02 (67) 2010, të 11 majit 2010.

12. Më 7 dhjetor 2012, Gjykata Komonale në Deçan dorëzoi në Gjykatë dosjen jo të plotë të lëndës E. Nr. 648/2010.
13. Më 18 mars 2013, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë dhe nga Komuna e Junikut që, në afat prej 15 ditësh, të informojnë Gjykatën për veprimet e fundit të Gjykatës Themelore për zbatimin e Vendimit të KPM-së, Nr. 02 (67) 2010, të 11 majit 2010, dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. Nr. 164/2011.
14. Më 2 prill 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që, në afat prej 15 ditësh, të informojë Gjykatën përkitazi me atë se a i është bërë kompensimi monetar për periudhën sa ishte në fuqi kontrata e tij dhe se a ka ndërmarrë parashtruesi ndonjë veprim pas nxjerrjes së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. Nr. 164/2011, sa i përket zbatimit të këtij aktvendimi.
15. Më 8 prill 2013, Komuna e Junikut dorëzoi në Sekretariatën e Gjykatës përgjigjen e saj përkitazi me kërkesën e parashtruar nga Gjykata më 18 mars 2013.
16. Më 10 prill 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë përgjigjen në kërkesën e parashtruar nga Gjykata më 2 prill 2013.

### **Përmbledhja e fakteve**

17. Parashtruesi i kërkesës, nga 1 tetori 2009, ka punuar vozitës në Komunën e Junikut, në cilësinë e shërbyesit civil, sipas kontratës së punës, Nr. 22/1, të 1 tetorit 2009, lëshuar nga Komuna e Junikut, deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Parashtruesi ka pasur kontratë pune në kohëzgjatje deri më 1 tetor 2010, me mundësi vazhdimi.
18. Në bazë të shkresës të 10 shkurtit 2010, të deponuar në lëndë nga parashtruesi, parashtruesi i kërkesës deklaroi se më 5 shkurt 2010, është thirrur në zyrën e Kryetarit të Komunës së Junikut ku i është komunikuar se është përjashtuar nga puna pa ndonjë arsytim. Në këtë shkresë, parashtruesi kërkon nga Kryetari i Komunës së Junikut sqarim me shkrim për arsyen e largimit nga puna.
19. Më 8 shkurt 2010, në bazë të Vendimit me Nr. 01/07, parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Kuvendin Komunal të Junikut, me arsyetimin se ka pasur mungesë të vlerësimit formal vjetor dhe mungesë të vlerësimit të periudhës provuese.
20. Më 12 prill 2010, parashtruesi parashtrroi ankesë në KPM kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke kërkuar nga KPM-ja që ta obligojë organin e punësimit të rishqyrtojë rastin dhe ta kthejë atë në marrëdhënie pune, në pajtim me kontratën e punës, si vozitës në Komunën e Junikut.



21. Më 11 maj 2010, KPM-ja, bazuar në shkresat e lëndës dhe aktet ligjore në fuqi, nxori Vendimin Nr. 02 (67) 2010 dhe e aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Vendimin e Komunës së Junikut, Nr. 01/07, të 8 shkurtit 2010, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Me këtë vendim, KPM-ja obligoi organin e punësimit që, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ta kthejë parashtruesin në vendin e punës si vozitës dhe t'i mundësojë parashtruesit realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e punës Nr. 22/1, të 1 tetorit 2009.
22. Më 27 maj 2010, parashtruesi njoftoi KPM-në se Vendimi 02 (67) 2010, i 11 majit 2010, i aprovuar nga ky organ, nuk po zbatohet nga Komuna e Junikut.
23. Më 8 qershor 2010, KPM-ja, e ka njoftuar Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për moszbatimin e vendimeve të këtij organi.
24. Më 19 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Deçan nxori Aktvendimin E. Nr. 648/2010 duke lejuar përmbarimin në bazë të titullit ekzekutiv të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës 02(67)2010, të 11 majit 2010. Me këtë titull përmbarues është aprovuar kërkesa e kreditorit Sali Pepshi nga Juniku me përmbajtje "anulohet vendimi i Komunës së Junikut mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, obligohet organi i punësimit që në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, kreditorit t'ia mundësojë realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës, në përputhje me kontratën e punës nr. 22/1 të dt.1.10.2009".
25. Më 10 maj 2011, KPM-ja i është drejtuar kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe ka kërkuar nga ai që ta shtrijë autoritetin e vet brenda kompetencave të ngarkuara si Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, që nga përgjegjësit e institucionit të punësimit të kërkojë që të respektohet dhe të zbatohet Vendimi i KPM-së për kthimin në vendin e punës të parashtruesit të kërkesës, z. Pepshi.
26. Më 5 korrik 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, duke vepruar sipas ankesës së ushtruar nga debitori -Komuna e Junikut, nxori Aktvendimin AC. Nr. 164/2011, me ç'rast hodhi poshtë ankesën si të pabazuar, duke vërtetuar kështu Aktvendimin e shkallës së parë, E. nr. 648/2010, të 18 prillit 2011.
27. Më 12 shkurt 2012, Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut nxori Vendimin Nr. 01/2, duke iu referuar Vendimit të KPM-së, Nr. 02 (67) 2010, të 11 majit 2010, ku theksohet që parashtruesit të kërkesës do t'i kompensohen të ardhurat personale që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, konform Vendimit Nr. 2/67, të 11 majit 2010, e deri në skadimin e kontratës më 1 tetor 2010, mirëpo, pasi kontrata nuk është më valide, e njëjta nuk ka më relevancë, përkatësisht nuk prodhon më asnjë efekt juridik.
28. Më 10 prill 2013, parashtruesi i kërkesës i është përgjigjur çështjeve të ngritura nga Gjykata dhe ka theksuar se nuk ka marrë kurrfarë kompensimi material që nga koha kur është larguar nga puna dhe se, pas nxjerrjes së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. Nr. 164/2011, ka tentuar ta bëjë këtë dhe ka

kërkuar këtë nga organet kompetente të Komunës së Junikut, mirëpo nuk ka hasur në mirëkuptim.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me moszbatimin e vendimeve gjyqësore nga institucioni i punësimit, Komuna e Junikut, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare:
- a. Nenit 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; dhe
  - b. Nenit 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor].

### **Dispozitat përkatëse ligjore sa i përket procedurave për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore**

#### ***Ligji për Procedurën Përmbarimore (Nr. 03/L-008)***

30. Në Republikën e Kosovës, rregullat ligjore, procedura zbatuese dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për Procedurën Përmbarimore (Ligji Nr. 03/L-008).

#### *“Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]*

*1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.*

*1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurë administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.*

#### *Neni 24 [Titulli ekzekutiv]*

*“Tituj ekzekutiv” janë:*

- a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;*
- b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;*
- c) dokumenti noterial ekzekutiv;*
- d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.*

#### *Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]*



*“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.*

*Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]*

*1. Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se debitori ka për detyrë që atij t’ia paguajë në emër të pagës shumë mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumëve mujore të caktuara”.*

### **Ligji Nr. 03/L-192 për KPM-në**

*“Neni 13 [Vendimet e Këshillit]*

*Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarë të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.*

*Neni 14 [E drejta e ankesës]*

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.*

*Neni 15 [Procedura në rast moszbatimi të vendimit të Këshillit]*

*a) Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.*

*b) Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njoftojë me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për ekzekutim.*

*c) Njoftimi nga paragrafi 2 i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

*d) Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të fillojë procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe*

*institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jomateriale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensojë shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit”.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

31. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjkata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
32. Gjkata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*. Në këtë drejtim, Gjkata vëren se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar që ka të drejtë të ngrejë këtë rast në Gjykatë në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës.
33. Gjkata gjithashtu përcakton nëse parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike pasi Gjykata e Qarkut në Pejë konsiderohet “gjykatë e shkallës së fundit për të gjykuar çështjet që lidhen me përmbarrimin”. Si rrjedhojë, parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të Kosovës.
34. Përveç kësaj, sa i përket kriterit që parashtruesi duhet të dorëzojë kërkesën brenda 4 muajsh pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë për rastin, Gjkata përcakton se situata e moszbatimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 164/2011, të 5 korrikut 2011; të Aktvendimit të Gjykatës Komonale në Deçan, E. Nr. 648/2010, të 18 prillit 2011, dhe të Vendimit të KPM-së, Nr. 02 (67) 2010, të 11 majit 2010, nga ana e Komunes së Junikut “vazhdon edhe sot” ( *shih Rastin KI50/12, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të parashtruesit Viktor Marku i datës 16 korrik 2012*).
35. Koncepti « situatë në vazhdim » tregon një gjendje të caktuar që rezulton nga veprimet në vazhdim të kryera nga shteti ose në emër të tij, ku kërkuessit janë viktimat. » ( *Iordache kundër Rumanisë*, Aplikacioni 6817/02, Aktgjykimi i dt.14.10.2008).
36. Në këtë drejtim Gjkata vlerëson se pyetja që duhet të konsiderohet në këtë rast, është nëse kalimi i afatit prej 4 muajsh nga dita e pranimit të vendimit të fundit gjyqësor (15 korrik 2011) është një pengesë e plotë për të parashtruar kërkesën në Gjykatë ose është një situatë e vazhdueshme, që akoma ekziston dhe eventualisht përbën shkelje të Kushtetutës, çdo ditë përderisa vendimi i KPM-së dhe Aktvendimet e gjykatave janë në fuqi dhe mbesin të pazbatuara.



37. Gjykata konsideron se afati prej 4 muajve i përcaktuar nga neni 49 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese lidhur me kërkesat individuale duhet të aplikohet me fleksibilitet dhe në rastet që për pasojë kanë prodhuar situatë të vazhdueshme e që mund të rezultojë me shkelje të vazhdueshme kushtetuese në dëm të parashtruesit të kërkesës, afati prej 4 muajve nuk mund të jetë pengesë për shqyrtimin e meritave të një kërkesë të tillë të parashtruar në Gjykatë.
38. Përveç kësaj, Gjykata përcakton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e nenit 48 të Ligjit: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”*. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi pretendon për shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës dhe të Nenit 6 të Konventës Evropiane.
39. Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

### **Vlerësimi i kushtetutshmërisë së kërkesës**

40. Pasi parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet t'i shqyrtojë meritat e kërkesës së parashtruesit.
41. Sa i përket parashtrësive të parashtruesit, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e konteston asnjë vendim të organeve publike, sepse të gjitha vendimet janë në favor të tij, prej vendimit të KPM-së e deri te vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë. Objekti i çështjes së kërkesës së parashtruesit ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të KPM-së dhe të vendimeve gjyqësore nga organet e Komunës së Junikut.
42. Gjykata vëren se, më 11 maj 2010, KPM-ja aprovoi ankesën e parashtruesit, Nr. 02 (67) 2010, e anuloi vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kërkoi nga organi i punësimit që, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, parashtruesit t'ia mundësojë realizimin e të gjitha të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. KPM-ja, më tej, konstatoi se vendimin e KPM-së duhet ta zbatojnë Kryetari i Komunës së Junikut dhe Drejtori për Administratë e Personel i Komunës.
43. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, më 19 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Deçan aprovoi propozimin e parashtruesit për ekzekutimin e vendimit të KPM-së dhe e detyroi debitorin, përkatësisht Kryetarin e Komunës së Junikut, t'i ndërmerre të gjitha masat e nevojshme për ta kthyer parashtruesin në postin e tij të mëparshëm, me të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës (Vendimi E. nr. 648/2010). Ky vendim u vërtetua edhe nga Gjykata e Qarkut në Pejë (Ac. nr. 164/2011).
44. Gjykata në relacion si më sipër konstaton se parashtruesi i kërkesës edhe pse me të gjitha vendimet administrative dhe gjyqësore ka fituar një të drejtë të cenuar nga organi i punësimit ai përkundër përpjekjeve të vazhdueshme nuk ka mundur ta realizojë të drejtën e fituar.



45. Dështimi për të ndërmarrë masa konkrete për zbatimin e vendimeve përfundimtare gjyqësore nga cilado komunë nuk është në përputhje me kriteret e nenit 124.6 të Kushtetutës, i cili qartazi përcakton se:

*“Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore”.*

46. Sa i përket sqarimit të pozitës dhe të juridiksionit të KPM-së, Gjykata konsideron se KPM-ja është institucion i pavarur, i themeluar me ligj, në përputhje me nenin 101.2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha detyrimet që dalin nga ky institucion, për çështjet që janë nën juridiksion të këtij institucioni, prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, në të cilat statusi i të punësuarve rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni është vendim përfundimtar administrativ dhe, si i tillë, duhet të përmbahet nga gjykata kompetente, siç propozohet për përmbarim nga një kreditor sa i përket realizimit të së drejtës së fituar në procedurë administrative.

47. Neni 6 i KEDNJ-së gjithashtu zbatohet për faza administrative të procesit gjyqësor, përkatësisht është brenda kornizës “për të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Prandaj, rezulton se moszbatimi i vendimit të KPM-së ashtu sikur edhe moszbatimi i vendimeve gjyqësore në këtë rast, bie nën fushëveprimin e nenit 6 të Konventës, dhe rrjedhimisht paraqet shkelje të tij.

48. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës, i cili thekson:

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*

49. Gjykata vëren se është e drejtë e palës së pakënaqur të iniciojë procedurë gjyqësore në rast se nuk e realizon të drejtën e fituar siç përcaktohet me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe me nenin 6 lidhur me nenin 13 të KEDNJ-së dhe se do të ishte e pakuptimtë sikur sistemi juridik i Republikës së Kosovës të lejonte që një vendim përfundimtar gjyqësor të mbetet i paefektshëm në dëm të njëjës palë. Interpretimi i neneve të sipërpërmendura ka të bëjë vetëm me qasjen në gjykatë. Prandaj, mosefikasiteti i procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte që sjellin situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, një parim që autoritetet e Kosovës janë të detyruara ta respektojnë (*Shih Vendimin e KEDNJ-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtrës Nr. 67534/01, Aktgjykim i 27 korrikut 2004*).

50. Gjykata konsideron se përmbarimi i një vendimi të shqiptuar nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e sipërpërmendura (*Shih, rastin Hornsby kundër Greqisë, Aktgjykim i 19 marsit 1997, Raportet 1997-II, f. 510, paragrafi 40*). Në këtë rast specifik, parashtruesi nuk do të duhej të privohej nga përfitimi i një vendimi përfundimtar, që është në favor të tij. Asnjë organ nuk mund ta justifikojë moszbatimin me qëllim të fitimit të një rishikimi dhe rishqyrtimi të ri të rastit (*Shih, Sovtransavto holding kundër Ukrainës, Nr. 48553/99*,

paragrafi 72, KEDNJ, 2002-VII; Prandaj, organet kompetente kanë për obligim të themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (*Shih, Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008*).

51. Në fund, kjo Gjykatë gjen se moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga ana e organeve kompetente të Republikës së Kosovës dhe dështimi për të siguruar mekanizma efikas për zbatimin e vendimeve përkatëse të organeve dhe të gjykatave përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 5 korrik 2013, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. Se ka pasur shkelje të nenit 31, 32 të Kushtetutës dhe nenit 6 lidhur me nenin 13 të KEDNJ;
- III. Se vendimi përfundimtar dhe përmbarimor i KPM-së, Vendimi nr. 02(67) 2010 i 11 majit 2010; Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 164/2011, i 5 korrikut 2011 dhe Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Deçan, E. nr. 648/2010, i 18 prillit 2011, duhet të ekzekutohen nga organi kompetent, në veçanti, nga Komuna e Junikut;
- IV. Në pajtim me Rregullin 63 (5) të Rregullores së Punës, Komuna e Junikut duhet t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;
- V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtar raportues**

Altay Suroy



**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani